

**1 DHJETOR**  
**DITA BOTËRORE KUNDËR**  
**AIDS**

**DREJT ZEROS**



**ZERO**  
**INFEKSIONE**  
**TË REJA**  
**NGA HIV**

**ZERO**  
**DISKRIMINIM**  
**PËR NJERËZIT**  
**ME HIV/AIDS**

**ZERO**  
**VDEKJE NGA**  
**AIDS**



INSTITUTI I SHËNETIT PUBLIK



Organizata Botërore  
e Shëndetësisë

ZYRA RAJONALE PËR Europën

# 10 FAKTE PËR HIV DHE AIDS



1. HIV infekton qelizat e sistemit imunitar dhe çon në uljen e aftësisë së organizmit për të shmangur disa infeksione dhe sëmundje. AIDS është faza më e avancuar e HIV-it.
2. HIV transmetohet në disa mënyra-nëpërmjet:
  - marrëdhënieve seksuale të pambrojtura me një person të infektuar;
  - transfuzioneve të gjakut të infektuar;
  - shkëmbimit të shiringave ose instrumenteve të tjera të mprehta të kontaminuara;
  - nënës së infektuar te fëmija i saj gjatë shtatzënisë, lindjes apo ushqyerjes me gji.
3. Ka disa mënyra për të parandaluar transmetimin e HIV-it si:
  - praktikimi i sjelljeve të sigurta seksuale si përdorimi i kondomit;
  - testimi dhe trajtimi për infeksione seksualisht të transmetueshme;
  - shmangia e drogave me injeksion, ose përdorimi i gjilpërave e shiringave të reja;
  - marrja e gjakut të sigurt ose produkteve të tij të sigurta-të jenë testuar për HIV.
4. Rreth 36.9 milionë njerëz në mbarë botën jetonin me HIV në 2014, 2.6 milion prej tyre fëmijë. Rreth 2 milion njerëz u infektuan me HIV vetëm në 2014. Prej fillimit të epidemisë rreth 34 milion njerëz kanë vdekur nga AIDS, nga këta 1.2 milion vetëm në vitin 2014.
5. Terapia antiretrovirale (ARV) e kombinuar parandalon shumëzimin e HIV. Nëse partneri HIV+ merr mjekim ARV, transmetimi seksual te partneri HIV- ulet deri 96%.
6. Deri në fillim të 2015, në mbarë botën 15 milion njerëz morën mjekim ARV. OBSH rekomandon fillimin e mjekimit ARV për të gjithë njerëzit me HIV.
7. Testimi për HIV ndihmon për të siguruar trajtimin. Testimi dhe trajtimi i HIV duhet të përshejtohet. Vetëm 51% e njerëzve me HIV e dinë statusin e tyre të infektimit.
8. Rreth 2.6 milionë fëmijë jetojnë me HIV. Sipas të dhënave të vitit 2014, shumica e tyre janë infektuar nga nënat HIV-pozitiv gjatë shtatzënisë, lindjes apo ushqyerjes me gji. Vetëm në vitin 2014 janë infektuar 220.000 fëmijë.
9. Eliminimi i transmetimit të HIV-it nga nëna te fëmija po bëhet realitet. Progres është bërë në parandalimin e transmetimit nga nëna te fëmija dhe mbajtjen e nënave gjallë. Në vitin 2014, 7 nga 10 gratë shtatzëna me HIV kanë marrë mjekim ARV.
10. HIV është faktori rrezikues më i fuqishëm për zhvillimin e tuberkulozit. Në vitin 2013, nga tuberkulozi kanë vdekur rreth 360 000 njerëz që jetonin me HIV.